# Programami

SCHÖNBERG, Arnold
- Drei Klavierstücke op.11*
  *(Tre pjese per Piano op.11*)*

SCHÖNBERG, Arnold
- Sechs Klavierstücke op. 19*
  *(Gjashte pjese per Piano op. 19*)*

WEBERN, Anton von
- Variationen für Klavier op. 27*
  *(Variacione per Piano op. 27*)*

BRAHMS, Johannes
- Variationen und Fuga über ein Thema von Händel op. 24
  *(Variacione dhe Fuge mbi nje teme te Händel-it op. 24)*

*- Veprat luhen per here te pare

Ne vjeshten e 1861 Johannes Brahms (1833 1897), i dhuron Clara Schumman-it per ditelindje "Variacione per nje mike te dashur", veper qe nje vit me vone publikohet nen titullin "Variacione dhe fuge mbi nje teme te Händel-it op. 24". "Variacionet" eshte nje veper mjeshterore ne te cilen Brahms-i perfshin komplet spektrin teknik e muzikal te lojes ne piano qysh nga tingellimi i çembalos se Barokut, deri ne romantiken e pianos moderne, e vlefshme si dhurate per nje pianist te mire. Richard Wagner ka lene kete vleresim: "Brahms-i kompozon siç do donte Bach-u te kompozonte", dhe Brahms-i vete quan variacionet si vepren e vet te preferuar.

# Ndihmuan


Fondacioni SOROS
Ambasada Austriake në Tiranë
Bashkia e Tiranës
Banka e Kursimeve
Arnold Schönberg Center në Vienë


# Koncert Portret

## vjeshta e tiranës '03

Tirana 02 - 10,11,2003



## Merita Rexha - Tërshana

piano

Diten e Hënë, 03.11.2003, ora 19.00
Holli i Teatrit Kombetar të Operas dhe Baletit



Merita Rexha - Tërshana

:: Pasi mbaron studimet në Liceun Artistik J. Misja në Tiranë në vitet 1986 - 1990 me pedagoge N. Porodini, në vitet 1990 - 1994 kryen studimet e larta për piano në Akademinë e Arteve, në klasën e prof. M. Kristidhi.Më pas kryen edhe disa kurse kualifikimi në Schleswig Holstein Musik Festival me Prof. P. Badura-Skoda (1995) dhe në Folkwgang Hochschule Essen me Prof. Till Engel (1998). Pas mbarimit të studimeve në Akademinë e Arteve, emërohet pedagoge në Katedrën e Pianos pranë kësaj Akademie.

Merita Rexha - Tërshana

:: M. Rexha - Tërshana është një ndër pianistet më aktive të jetës muzikore shqiptare bashkëkohore. Pjesëmarrëse në pothuaj të gjitha ngjarjet e rëndësishme të muzikës në Shqipëri (Festivali Vjeshta e Tiranës, Konkurse të ndryshme, etj.), ajo zotëron një repertor të gjerë me vepra të të gjitha kohrave dhe gjinive që është materializuar në dhjetra koncerte cilësore jo vetëm në Shqipëri, por edhe jashtë saj si ne Gjermani, Austri, Itali, Greqi, Zvicer etj. Ajo ka luajtur si soliste me orkestrat e RTSH, TOB, Filarmonia e Re Shqiptare, si dhe eshte pjestare e Ansamblit ASMUS. Ndër të tjera, M. Rexha - Tërshana është intepretuesja e premierave shqiptare të disa veprave bashkëkohore me të vërtetë virtuoze dhe problematike edhe për pianistë me eksperiencë shumë më të madhe, si integralja e veprave për piano të I. Xenakis.,etj. Gjithashtu ka luajtur në premierë absolute edhe shumë vepra të kompozitorëve shqiptarë. Për aktivitetin e saj, M. Rexha-Tërshana është nderuar me çmime të shumta, përmendim këtu mes të tjerave interpretuesja më e mirë në Festivalin e Muzikës së Re Shqiptare, maj 1996, etj.